



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 02.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.10.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " MBB Construction&NTP B-Ademaj", për aktivitetin: "Renovime de permiresime te infrastrukturës se institucioneve shendetesore" Nr. të Prok: 616 20 3353 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " MBB Construction&NTP B-Ademaj" e datës 02.10.2020 .

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 30.09.2020 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën e pretenduesit dhe lidhur me pretendimet e të njejtit ka konstatuar si vijon:

- Se pari nuk qendron pretendimi se ju keni dhene sqarime te mjaftueshme, pasi qe edhe vete ne kerkesen tuaj e keni cekur se vetem jeni deklaruar se qendroni prane çmimeve tuaja pa dhene asnje sqarim sipas kerkeses tone ku eshte kerkuar decidivisht qe te dorezoni deshmita nga prodhuesit per çmimet e dhena apo çfaredo lloj favorizimi qe keni nga te njejtit;
- Pretendimi se rregullat per tenderet jonormalisht te ulet kane te bejne vetem me rastet kur kerkohet çmimi me i ulet e jo çmimi me i ulet i poentuar eshte poashtu i pa bazuar pa marer parasysh qe ju thirreni ne Vendimet e OSHP-se. Pasi qe jeni bazuar ne Vendim te tille eshte dashte ta analizoni deri ne fund kur ceket se te kriteri i çmimit me poentim minimizohet mundesia e manipulimit me çmimet pasi qe sasia e realizuar nuk mund dhe nuk duhet te ndryshohet nga raportet sipas peshes se dhene. Bazuar ne kete nenkuptohet se edhe çmimet e poentuara per nentotalet e paramases do te duhej te ishin ne

harmoni me raportet e dhena nga Autoriteti Kontraktues. Ne tenderin per te cilin ju pretendoni se keni dhene çmime reale dua tua sqaroj se Autoriteti Kontraktues ka krahasuar vetem totalitetin e çmimeve te tenderueseve dhe jo çmimet per njesi dhe peshen e dhene ne oferten tuaj ne raport me peshimin e dhene ne paramasen e Autoritetit Kontraktues. Duke krahasuar peshimin tuaj me peshimin e dhene ju sqaroj si vijon per disa nga punimet e kerkuara:

-Punet pergatitore e peshuar nga AK-ja me 1.70% ne oferten tuaj peshon 0.39%;

-Punet e demolimeve e peshuar nga AK-ja me 10%,sipas ofertes tuaj 0,14 %;

-Punet e betonit e peshuar nga AK-ja me 2%,sipas ofertes tuaj 0.07 %;

-Punet suvatimit dhe ngjyrosjes e poentuar nga AK-ja me 13%,sipas ofertes tuaj 2.20 %;

-Punet e zdrukthtarise e peshuar nga AK-ja me 8.50 %,sipas ofertes tuaj 41.12% e tjera nentotale qe ne asnje rast nuk jane ne harmoni me peshimin e paraqitur ne tender nga Autoriteti Kontraktues. Pra, keto dallime te medha ne mes te peshimit te dhene nga AK-ja dhe peshimit te paraqitur ne oferten tuaj pikerisht jane maksimizim i manipulimit me çmime. Do te pajtoheshim edhe ne se kemi te bejme me minimizim te manipulimit nese perafersisht ne çmimet tuaja do te respektohej peshimi i dhene nga Autoriteti Kontraktues.

Verjetje: Peshimi i AK-se eshte dhene ne paramase, ndersa peshimi nga tenderi juaj eshte bere me raportin e krahasimit te çmimit te peshuar per nentotal dhe çmimit total me peshim.

-Poashtu duhet t;ua rikujtojme se Rregullat per tenderet jonormalisht te ulet kane piken 3.2 ku decidivisht shkruan: **Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.**

Poashtu ne piken vijuese eshte përcaktuar qarte si vijon:

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja **"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"**.

4.3 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Te gjitha keto percaktime ligjore jane marre per baze nga Autoriteti Kontraktues dhe bazuar ne te njejtat jane kerkuar sqarimet, por ju keni dhene vetem deklarate verbale pa asnje deshmi sipas pikave te paraqitura te Rregullores se lartecekur.

Bazuar ne kete ka qene obligim ligjor I yni qe te mos pranojme çmimet vertet manipuluese nga tenderi juaj si qe jane: Pozicioni 3.4 Furnizimi, transporti dhe shtrirja e rese 0-4 mm (ne

gjendeje te ngjeshur) me çmim prej 0.10 € per meter kub, pozicionet nga 4.1-4.12 per nje meter kub beton me çmim prej 0.10 €; pozicioni 5.4 te muratimi me 0.10 €; pozicioni 5.9 dhe 5.10 te muratimi me çmime prej 0.01 €, pozicioni 7.7 me çmim prej 0.10 €. e shume pozicione tjera qe jane cekur ne kerkesen per sqarim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës, departamentit të prokurimit dhe njësisë së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, nese ka deshmi dhe argumente lidhur me kerkesen e vet ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit